



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**BALKAN
TENDER
WATCH**

Y A H R
YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PER DREJTAT E NJERIUT

MEMURANDUM MIRËKUPTIMI

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më:	02. 03. 20	
Primi ljen:		
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-400-	12993	

Memorandumi është shprehje e vullnetit të dyanshëm në mes OJQ-së Youth Association for Human Rights (në tekstin e mëposhtëm YAHR) nga Lipjani dhe Kryetarit të Komunës së Lipjanit për Implementimin e Projektit: "Citizens for good governance" në Komunën e Lipjanit.

Ky Memorandum i mirëkuptimit lidhet në mes:

1. OJQ-së YAHR Lipjan dhe
2. Kryetarit të Komunës së Lipjanit

Neni 1.

Burimi i projektit

1. Projekt i lartë cekur është pjesë e projektit rajonal "BALKAN TENDER WATCH", që financohet nga fondet e Bashkimit Evropian (BE) dhe zbatohet nga OPEN SOCIETY FOUNDATION. Donatori i këtij projekti nuk mbanë asnjëpërgjegjësi në lidhje me qëndrimet, bindjet, vlerësimet dhe rekomandimet që dalin nga organizata implementuese e projektit

Neni 2.

Qëllimi i Projektit

1. Qëllimi i këtij memorandum të mirëkuptimit është fuqizimi i bashkëpunimit në mes Komunës dhe Organizatave të Shoqërisë Civile që ka të bëjë avancimin e institucioneve lokale.
2. Qëllimi i këtij projekti është:

- a. Monitorimi i performancës komunale dhe të transparencës se si janë shpenzuar paratë e tatimpaguesit përmes prokurimit publik, duke eksposuar praktika të dobëta, qëllime të paligjshme dhe rritje të kërkesës për përgjegjësi institucionale,
- b. Avokim për qeverisje të përmirësuar, me rekomandime konkrete se si të përmirësohet legjislacioni aktual, si të përmirësohen praktikat dhe si të rritet përgjegjësia institucionale në menaxhimin e parave publike.

Neni 3.

Obligimet e palëve

1. Komunës së Lipjanit:

- 1.1. Obligohet Komuna e Lipjanit lejimin e ekipit monitoruesve të organizatës YAHR qasjen nëproceset e monitorimit, Pjesëmarrje në Komisione dhe proceset tjera në cilësinë e vëzhguesve.
- 1.2. Obligohet Komuna e Lipjanit të japë të dhëna statistikore, dokumente të dosjeve tétenderëve dhe informata të tjera lidhur më lëndët që kanë të bëjë me procedurat e prokurimit publik,
- 1.3. Obligohet Komuna e Lipjanit ta njoftojë me kohë organizatën YAHR lidhur me aktivitetet e prokurimit publik lidhur me kontratat e caktuara që janë përzgjedhur paraprakisht nga organizata YAHR

2. OJQ YAHR Lipjan:

- 2.1. Organizata YAHR do të bëjë monitorimin e aktiviteteve të Prokurimit Publik në Komunën e Lipjanit më qëllim të ngritisjet së performancës komunale dhe të transparencës lidhur me shpenzimet e parasë së tatimpaguesit përmes prokurimit publik
- 2.2. YAHR-i do të bëjë monitorimin e një kontrate që nga procedura e planifikimit të aktiviteteve të prokurimit deri tek procesi i dorëzim pranimit nga Operatoret Ekonomik,
- 2.3. Ekipi monitorues i YAHR-it do të përbëhet nga një ose dy monitorues të cilët do të mbajnë shenja dallues që do të tregojnë identitetin e tyre,
- 2.4. Ekipi monitorues i YAHR-it do të përbahet rregulloreve te Kodit Etikë të YAHR-it në mënyrë që të mos pengojë nëaktivitetet e Prokurimit Publik,

Neni 4.

Përgjegjësit e palëve

1. Kryetari dhe Komuna e Lipjanit nuk mbajnë asnjë përgjegjësi rrëth implementimit të këtij projekti, përvèç obligimeve të shprehura në nenin 2 të këtij memorandumi.
2. Organizata YAHR-është përgjegjëse që gjatë implementimit të këtij projekt të mos pengojëmirëvajtjen e proceseve të prokurimit publik,

3. Në rast se nga menaxhmenti i Komunës së Lipjanit në fjalë vijnë vërejtje në raport me sjelljen e monitoruesve brenda Kornunës gjatë kryerjes të detyrave të monitorimit, Kryetari i Komunës i përcjellë me shkrim vërejtjet tek menaxhmenti i organizatës YAHR, ku organizata YAHR është obliguar që të ndërmarrë masa adekuate mbi rregulloret e tyre të brendshme etike dhe deri të përjashtim i monitoruesve dhe zëvendësim i tyre me të tjerë,
4. Organizata YAHR gjatë punës monitoruese do të jetë transparente karshi Komunës së Lipjanit gjatë publikimi të raporteve dhe aktiviteteve të saj si që janë: Raportet monitoruese, tryezat e rrumbullakëta, konferencat për media etj.

Neni 5

Implementimi dhe ndryshimi i këtij memorandumi

1. Implementimi i këtij memorandum do të monitorohet nga Drejtori ekzekutiv i YAHR-it dhe njëherë koordinator i këtij projekti dhe nga Komuna e Lipjanit,
2. Ky memorandum i mirëkuptimit mund të ndryshohet apo të plotësohet sipas marrëveshjes të arritur me shkrim në mes dy palëve nënshkruese,

Neni 6.

Hyrja në fuqi

1. Ky memorandum është hartuar në dy kopje origjinale dhe i ka gjithsej tri faqe, ku secila palë nënshkruese do ta ketë nga një kopje origjinale,
2. Memorandumi do të hy në fuqi nga momenti i nënshkrimit të palëve dhe do të përfundojë deri në përfundimin e projektit në fjalë.



Békim Krasniqi
Drejtor Ekzekutiv i YAHR-it



Imri Ahmeti
Kryetari i Komunës së Lipjanit

Lipjan 2 ~~MEI~~ 2020